



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.04.2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Grida Duma – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Në kuadër të Ditës Botërore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, Komisioni do të zhvillojë seancë dëgjimore publike me institucionet publike lidhur me kërkesën e ardhur në komision nga Qendra për të Drejtat në Punë.

Marrin pjesë:

Grida Duma, Klodiana Spahiu, Ilirian Pendavinji, Dasantila Tahiraj, Florenc Spaho, Mirela Pitushi, Shpresa Marnoj, Ilir Metaj, Gertjan Deda, Petrit Vasili, Tatiana Pirro, Lindita Buxheli, Orjola Pampuri, Tritan Shehu, Ilda Dhori, Albana Vokshi, Mesila Doda dhe Zheni Gjergji dhe Antoneta Dhima.

Mungojnë:

Niko Kuri, Anila Denaj dhe Seladin Jakupllari.

Të ftuar:

Irida Qosja – Zëvendëskryeinspektore dhe drejtore e Drejtorisë së Inspektimit të Punës në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Eda Beqiri – Përgjegjëse e Sektorit të Mbikëqyrjes së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Edison Hoxha – Drejtor i Qendrës për të Drejtat në Punë

Gentiana Hasalla – Juriste e Qendrës për të Drejtat në Punë

Mirela Arqimandriti – Drejtore e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim
Esmeralda Hoxha – Koordinatore e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim
Edvin Prençi – Kryetar i shoqatës “Pro-Eksport” Albania
Florian Zekja – Koordinator i shoqatës “*Pro-Eksport Albania*”
Genci Stroni – Mjek në Sindikatën e Shëndetësisë

HAPET MBLEDHJA

Grida Duma – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me këtë rend dite (së pari, kemi çështjen e sigurisë në punë): seancë dëgjimore me rastin e ditës Botërore të Sigurisë së Shëndetit në Punë me përfaqësues të institucioneve publike dhe të shoqërisë civile.

Nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, kush është prezent?

Ju lutem, prezantohuni!

Irida Qosja – Jam zëvendëskryeinspektore dhe drejtore e Drejtorisë së Inspektimit të Punës në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Grida Duma – Mirë se erdhët!

Nga Qendra për të Drejtat në Punë?

Edison Hoxha – Jam drejtor ekzekutiv i Qendrës për të Drejtat në Punë.

Grida Duma – Mirë se erdhët, zoti Hoxha!

Gentiana Hasalla – Jam menaxhere e programit të Qendrës për të Drejtat në Punë.

Grida Duma – Mirë se erdhët!

Shoqata “Pro-Eksport Albania”?

Edvin Prençi – Përshëndetje!

Jam kryetar i shoqatës “Pro-Eksport Albania”, përfaqësues i fasonerisë dhe i manifakturës shqiptare.

Grida Duma – Mirë se erdhe!

Nga *Olof Palme International Center Albania*? Nuk i kemi prezentë. Kemi sindikatën, doktorin.

Mirë se erdhët!

Mund të afroheni, nuk keni pse qëndroni në fund.

Nisim dëgjesën me Inspektoratin Shtetëror të Punës.

Ju lutem, duke ju kërkuar mirëkuptimin, sa më koncizë, meqenëse e kemi kohën e limituar, pasi komisioni do të vijojë më pas me një çështje tjetër.

Zonja Qosja.

Irida Qosja – Ne, në fakt, kemi paraqitur një informacion, mund të lexoj materialin që kam sjellë pranë komisionit. Çështja e sigurisë është e gjerë, nëse do ta lexoj, do të marr shumë kohë.

28 Prilli është Dita Ndërkombëtare Botërore për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë për të promovuar parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale në nivel global. Aktivitet, në kuadër të kësaj dite kanë qëllim përqendrimin e vëmendjes ndërkombëtare në trendin e zhvillimeve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, në veçanti të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Siguria dhe shëndeti në punë janë elemente thelbësore në rritjen e cilësisë së jetës së gjithsecilit, që është në një marrëdhënie pune. Krijimi i kushteve të favorshme të punës, përshtatja e tyre ndaj nevojave të punëdhënësve dhe punëmarrësve janë jetike për një rritje të motivimit të të gjithë punonjësve, duke dhënë kontribut të drejtpërdrejtë për efikasitet më të lartë në punë.

Veprimtaria e këtij institucioni mbështetet në të dyja ligjet bazë të inspektimit: në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjin nr. 9634, datë 30.10.2006, “Për Inspektimin e Punës”, i ndryshuar” dhe konsiston në vizita inspektuese, këshilluese e kontrolluese, të cilat shoqërohen me masa specifike për çdo rast inspektimi, në funksion të zbatimit më përpikëri të legjislacionit të punës.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në bazë të urdhrin nr. 156, datë 24.11.2020, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, operon me veprime inspektuese, me staf prej 94 inspektorësh në pune terreni, 13 përgjegjës sektori, që së fundi janë të organizuara në 6 drejtori rajonale dhe 13 sektorë inspektimi. Këta të fundit janë organizuar në nivel qarku.

Aktualisht procedura e inspektimit kryhet sipas programit të inspektimeve, bazuar në vlerësimin e riskut për informalitet apo kushte të sigurta, të shëndetshme pune për punëmarrësit, bazuar në specifikat e aktiviteteve ekonomike dhe qarqeve. Historiku i inspektimeve të kryera nga inspektorët e punës, si dhe regjistri i subjekteve të deklaruara në QKB dhe DPT shërben si bazë programimi për inspektimin, ndërkohë që inspektimet kryen edhe mbi bazë denoncimi apo mbi bazën e aksidentit të ndodhur në punë. Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe qendror me QKB-në

dhe DPT-në për përditësimin e të dhënave të subjekteve të reja dhe punëmarrësve të rinj, me qëllim monitorimin e marrëdhënieve të tyre të punësimit, shërben si një shtim i subjekteve mbi bazë programimi, si element risku, subjekteve të reja, të cilat bëhen objekt këshillimi nga inspektorët e punës. Aktualisht procedura e inspektimit kryhet *online* dhe me përmirësime të vazhdueshme të sistemit “e-Inspektimi”, i cili administrohet nga inspektorati qendror. Për inspektorët e punës është mundësuar akses i të dhënave të deklarimit të subjekteve për punonjësit e tyre në kohë reale, akses i siguruar në sistemin *e-Tax* të tatim- taksave për të pasur informacion për çdo të punësuar që nga deklarimi i tij.

Një zë jo më pak i rëndësishëm në aktivitetin e inspektoratit është edhe zhvillimi i fushatave ndërgjegjëse dhe informuese për sektorë të caktuar apo çështje të caktuara, të cilat ndikojnë në rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit për të drejtat dhe detyrimet për punëmarrësit dhe punëdhënësit.

Për vitin 2021 janë inspektuar me procedurë standarde inspektimi 7039 subjekte ekonomike private e shtetërore, ku janë evidentuar të punësuar 184,206 punëmarrës, ndërkohë që për 3-mujorin e parë të vitit 2022 janë inspektuar 2581 subjekte.

Aksidentet në punë

Nga të dhënat e vitit 2021 dhe 3-mujorit të parë të vitit 2022, kemi tendencë në rritje të vogël të numrit të punëmarrësve të aksidentuar në punë. Kjo është rezultat i rritjes së ndërgjegjësimit të punëdhënësve për deklarimin e çdo rasti aksidenti. Ajo që duhet thënë është që tendenca e punëmarrësve të aksidentuar me pasojë fatale, do të thotë raste fatale të aksidenteve në punë, kanë një tendencë në rënie nga viti në vit. Për sa u përket masave administrative të marra për rastet e aksidenteve në punë për vitin 2021, në 207 inspektime të kryera për aksidentet në punë janë marrë 82 paralajmërime, 19 pezullime për shkelje flagrante të marrëdhënieve të punës dhe sigurisë, 58 sanksione me vlerë gjobash 14 milionë e 980 mijë lekë.

Në tremujorin e parë të vitit 2022 kemi 49 inspektime për aksident në punë, 18 paralajmërime, në 4 subjekte është bërë pezullimi i shkeljes, pezullimi i aktivitetit dhe janë vendosur 13 sanksione me vlerë 3 milionë e 100 mijë lekë.

Për sa u takon inspektimeve për aksidentet, aktualisht Inspektorati i Punës po përdor një politikë, qasje të ndryshuar nga më parë, pasi tashmë po përfshijmë në inspektim aksidenti të gjitha subjektet që janë pjesë në aksident. Flasim në një kantier ndërtimi ku punojnë disa subjekte edhe si nënkontraktorë, pavarësisht se kujt i përket i punëmarrësi i lënduar apo i aksidentuar, janë të

përfshirë të gjitha subjektet, prandaj në numrin 207 dhe 49 jo domosdoshmërisht është shifra e punëmarrësve të aksidentuar, por është numri i subjekteve të inspektuara pikërisht me këtë indicie.

Aksidentet më të mëdha i gjejmë në sektorin e ndërtimit, në aktivitetet e elektricitetit, në miniera, ku ka një tendencë në rritje edhe në sektorin e tregtisë, pasi pandemia diktoi një qasje, morën hov, zhvillim shërbimet *online*, tregtia përmes *delivery*-t. Kemi të regjistruara aksidente të punonjësve që punojnë motoristë për shpërndarjen e postës. Ky konsiderohet, në bazë të ligjit, aksident në punë, por shkak i ndodhjes lidhet me zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor, pasi mjete motorik është mjet i punës, por është në rrugë.

Në 77 % të të punëmarrësve të aksidentuar jo me pasojë vdekje, shkaqet lidhen drejtpërdrejt me kushtet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, por ka edhe shkaqe të tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me punën si: gjendja shëndetësore e punëmarrësit, sëmundje e përgjithshme, ku gjatë orarit të punës ka pësuar infarkt, i cili ka sjellë humbje të menjëhershme të jetës; të kushteve atmosferikë të kohës, ngricat, dëbora apo pengesat në rrugë kanë sjellë që punëmarrësit të aksidentohen gjatë kryerjes së punës.

Në lidhje me kontrollin e subjekteve i vihet një theks i madh të dhënave për funksionimin e sistemit të sigurisë dhe shëndetit në punë në rang subjekti. Të dhënat tona flasim që një pjesë e mirë e subjekteve kanë ngritur Këshillin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. Për këtë këshill edhe ne jemi skeptikë. Nga muaji mars Inspektorati i Punës është i angazhuar me urdhrin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, si ministria përgjegjëse që mbulon fushën e punës "Për kryerjen e Inspektimeve në subjektet fasone nga ISHPSHSH". Kemi bërë një punë përgatitore duke nxjerrë të gjithë listën e subjekteve fasone aktivë që janë deklaruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për të bërë një vlerësim real të riskut të çdo subjekti, pasi edhe ne si inspektorat kemi përmirësuar ndjeshëm programin e inspektimit ose më saktë platformën ndërgjegjësuese, e cila na shërben dhe ka të dhëna për të pasur një program programimi inspektimesh mbi bazë vlerësimi risku. Për këtë na duhet risku real. Deri tani janë realizuar 91 inspektime në këtë aktivitet me një numër prej 6153 punëmarrësish. Një pjesë e tyre rezultojnë të jenë aktivë në QKB, por që nuk e ushtrojnë realisht aktivitetin e tyre ekonomik. Duhet të kuptojmë që vijmë nga një vit pandemik, nga një periudhë pandemie, e cila preku më së shumti sektorin fason, ku një pjesë e tyre ende nuk janë në punë. E gjithë fushata ka qëllim që të shtrihet në dy nivele, në nivelin e kontrollit për të kuptuar edhe informalitetin në pagë, pasi është një sektor, i cili mban së shumti informalitetin gri, nuk e kemi të gjithë marrëdhënien e punës të deklaruar, të gjitha elementet që përbëjnë një marrëdhënie pune

të deklaruar dhe të paguar. Flasi për punën e kryer në orët shtesë, punën e kryer në turne, punën e kryer në ditët e festave zyrtare, lejet e zakonshme, të cilat nuk po kryhen në të gjitha subjektet. Fokusi kryesor ka qenë edhe respektimi i pagës minimale për këtë kategori. Kemi gjetje, një analizë të mirë të subjekteve fashë të kësaj fashatë. Ne do ta ndajmë sapo ta përfundojmë të gjithë kontrollin, sepse ai po vazhdon, jemi në proces të tij. Ndërkohë, këtë fashatë po e orientojmë paralelisht edhe si një fashatë ndërgjegjësimi, me inspektorë të drejtorisë qendrore të Inspektoratit të Punës. Kemi përgatitur një fletëpalosje të posaçme me informacione në gjuhë të thjeshtë për punëmarrësit e këtij sektori, për të drejtat dhe detyrimet, sepse, duke u njohur me të drejtat, janë ata të cilët do të jenë të parët që nuk do të pranojnë më të punojnë në ato kushte ose do të kërkojnë përmirësimin e kushteve të punës së tyre dhe do të jenë një zë i shtuar për të marrë informacion. Por edhe në tryezat me punëdhënës të kësaj kategorie, jemi me zotin Premçi, me Shoqatën e Punëdhënësve në manufakturë, në një proces; me Pro-Eksport, kemi organizuar dy takime në Shkodër e në Durrës me punëdhënës të këtij sektori.

Grida Duma – Dakord.

E mbyllim në këtë moment, se besoj këto detaje mund të dalin nga dëgjesa me grupe të tjera përfaqësuese.

Vijojmë dëgjesën me grupin e dytë të interesit: Qendra për të Drejtat në Punë.

Edison Hoxha – Jam drejtori ekzekutiv i kësaj qendre.

E nderuar zonja kryetare,

E nderuar zonja nënkryetare,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Fillimisht me lejoni që, edhe në cilësinë e iniciatorit kryesor të kësaj tryeze, të vlerësoj angazhimin e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë për gatishmërinë që ka treguar për të qenë i hapur me shoqërinë civile dhe me grupet e interesit. Këtë e kemi vënë re në vazhdimësi në të kaluarën. Unë dua të vlerësoj dhe rolin e Kuvendit të Shqipërisë në përfshirjen e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në procesin e integritit europian.

Nga ana tjetër, ne kërkojmë që kjo frymë të shtrihet edhe në institucionet ekzekutive, siç janë Ministria e Financave, ministria përgjegjëse për punën, e cila nuk e ka këtë të qasje kaq të hapur dhe pozitive ndaj këtyre grupeve të interesit. Do të ishte shumë pozitive që ministria, si dhe të gjitha institucionet ekzekutive ta kishin këtë qasje qoftë në aspektin e proceseve konsultuese, qoftë edhe në takimet periodike të hapura për çështje të caktuara, në ditë të shënuara siç është ky

takim, në kuadër të të cilit organizohet takimi i sotëm. Mendoj që ky dialog të vendoset në një lloj standardi dhe në ditë të caktuara, që janë ditë të shënuara, siç është dita e 28 Prillit, që është Dita e Sigurisë së Shëndetit në Punë, të bëhet një takim, të jetë diçka periodike, aq sa është e mundur, duke parë edhe axhendën e komisionit, por duke parë edhe ditët e tjera, siç është dita e 7 Tetorit, që është Dita e Punës së Denjë, një ditë ndërkombëtare shumë e rëndësishme.

Nga ana tjetër, dua të theksoj përpara komisionit faktin që do të ishte shumë e vlerësueshme nga ana jonë që t'i tërhiqej vëmendja qeverisë nga ana e Kuvendit për një qasje shumë më proaktive ndaj standardeve të punës dhe jo thjesht një qasje ndaj politikave të punësimit apo arsimit profesional. Është shumë e rëndësishme, punësimi, patjetër është më i ndjeshëm ndaj qytetarëve, ndaj masës, elektoratit, por shumë e rëndësishme është edhe pjesa e standardeve të punës. Ndërkohë, ne vëmë re nga vlerësimi ynë, nga ajo që kemi vënë re në terren se nuk është qasja e duhur proaktive. Këtë mund t'juja ilustruj me raste konkrete, kemi një vëmendje shumë pozitive, shumë të rëndësishme të qeverisë ndaj politikave të nxitjes së punësimit, duke filluar që nga miratimi i një ligji të ri në vitin 2019 "Për nxitjen e punësimit", nga krijimi i një agjencie të posaçme për aftësimin dhe punësimin. Kjo është shumë pozitive, nga ana tjetër duhet të përqendrohet vëmendja dhe te standardet e punës, te kushtet e punës. Kjo jo sepse duhet bërë, por sepse kjo është e lidhur ngushtësisht me disa fenomene që ne i hasim çdo ditë në vazhdimësi, siç është fenomeni i emigracionit. Në vlerësimin tonë, një nga arsytet thelbësore pse të rinjtë apo popullata emigron dhe vazhdon të emigrojë është fakti se, pavarësisht se ata mund të punësohen, mungon pjesa pas punësimit, që lidhet me standardet dhe me respektimin e standardeve të punës. Kjo është shumë e rëndësishme dhe ne do të donim angazhimin e komisionit, të Kuvendit e të gjitha strukturave për ta adresuar këtë fenomen, si dhe për të pasur një vëmendje shumë më të madhe në këtë aspekt, të mos lihet siç është lënë deri sot që ne vëmë re që lihet në dorën e Inspektoratit të Punës. Ky i fundit është shumë i rëndësishëm, por ai nuk mund ta bëjë dot i vetëm këtë gjë. Ne vëmë re mungesë të angazhimit thelbësor të angazhimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në këtë aspekt. Kjo e fundit nuk është asgjëkund. Edhe pse vitet vite e fundit ka një përmirësim të strukturës brenda ministrisë për marrëdhëniet e punës dhe dialogun social, përsëri është thjesht një formalitet që nuk e bën rolin thelbësor që duhet të kishte realisht. Ne vlerësojmë si shumë të pakuptimtë edhe një aspekt tjetër, që ka dalë kohët e fundit në pah, gjatë vitit 2021 përfaqësuesja e Inspektoratit e përmendi që janë 94 inspektorë, ndërkohë ne vëmë re se ka 22 vende vakante të paplotësuara në strukturën e Inspektoratit Shtetëror të Punës. Ne flasim për

mangësi të numrit total dhe kërkojmë të ketë më shumë inspektorë, që është një kërkesë shumë e arsyeshme, por nuk i plotësojmë vendet vakant që duhen bërë. Janë 22 vende vakante të paplotësuara nga organika e Inspektoratit Shtetëror të Punës.

Një aspekt tjetër, që doja ta theksoja është fakti që është në proces shqyrtimi pranë Kuvendit të Shqipërisë një projektligj për përgjegjësinë financiare të punonjësve publikë, është një iniciativë që është ndërmarrë nga ish-kryetari i KLSH-së, i cili ka dashur të adresojë një fenomen që lidhet me abuzimin e mundshëm që ndodh nga punonjësit publikë në shpërdorimin e detyrës, të fondeve apo të detyrës funksionale që kanë.

Ky është shqetësim shumë real, është shqetësim shumë i drejtë dhe duhet të adresohet, por mënyra se si e adreson ai projektligj nuk është mënyra e duhur. Ne në momentin e duhur mund të japim edhe kontributin dhe ekspertizën tonë shumë të detajuar në kuadër të këtij arsytimi që sapo bëra, por ai nuk e adreson, ai thjesht e përkeqëson situatën dhe do t'i vendosë të gjithë punonjësit publikë në një situatë jo të favorshme dhe abuzive, prandaj edhe kërkojmë që të shihet me vëmendje edhe kur të vijë këtu në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Ky projektligj të mund të adresohet dhe mund të korrigjohet, me qëllim që të përmirësohet dhe të bëhet ashtu siç, në fakt, duhet të jetë, sepse, ashtu siç është paraqitur, ne e kemi parë që nuk e adreson fenomenin e abuzimit potencial të punonjësve publikë në kryerjen e detyrës. Për 3-4 pika që ne na shqetësojnë, pa hyrë fare në detaje, në lidhje me sigurinë e shëndetit në punë në përgjithësi pastaj do t'ia lë fjalën koleges të flasë diçka shumë shkurtimisht.

Ne na shqetëson pjesa e parandalimit, pjesa e mungesës së një kulture parandaluese. Ne nuk mund të përqendrohemi me rikuperimin e pasojave, vetëm kur ndodh aksidenti të merremi me rikuperimin e pasojave.

Ne duhet të punojmë shumë më tepër me vendosjen e një kulture parandaluese, me qëllim që, sa të mundemi, sepse asnjëherë nuk shmangen plotësisht aksidentet në punë, fatkeqësisht, të mund t'i shmangim e t'i minimizojmë këto aksidente në punë.

Na shqetëson, gjithashtu, përfshirja reale e punonjësve në procesin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Janë punonjësit ata që do të duhet të angazhohen në mënyrë aktive, me qëllim që ta garantojmë sigurinë e shëndetit në punë më mënyrë të qëndrueshme. Sado të angazhohen institucionet, inspektorët etj., që nuk janë në vendin e punës, përsëri nuk do ta adresojmë këtë fenomen, por do të duhet që t'i angazhojmë punonjësit në këtë proces sa më shumë të mundemi dhe në mënyrë sa më reale.

Duhet të rritim ndërgjegjësimin e punëdhënësve që të mos e shohin si kosto këtë proces. Kjo është shumë e rëndësishme, madje punëdhënësit kanë rolin më të rëndësishëm, mendoj unë. Ne duhet të punojmë me të gjithë punëdhënësit që ky proces të mos shihet si një kosto ekstra për ata, por të shihet si një benefit që do t'i vijë rritjes së produktivitetit, sepse, tek e fundit, atë qëllim kanë dhe është shumë normale ta kenë, por duhet që të punojmë me këta në këtë drejtim shumë më tepër, në mënyrë që të ndryshohet ky lloj perceptimi.

Duhet të punojmë shumë më tepër në lidhje me zbatimin dhe ekzekutimin e sanksioneve. Unë jam munduar të shoh se sa nga sanksionet, që janë vendosur sidomos nga Inspektorati i Punës, ekzekutohen dhe nuk kam arritur në konkluzionin që këto sanksione që vendosen gjatë viteve, 2021 apo edhe më parë, ekzekutohen në mënyrë të menjëhershme.

Ne duhet të punojmë që sanksionet që vendosen, do të duhet të ekzekutohen, sepse, pavarësisht se ai nuk është qëllimi parësor, tek e fundit, ato kanë qëllim që të edukojnë ata mbi të cilët vendoset ky sanksion. Gjithashtu, një pikë tjetër shumë e rëndësishme është që ne duhet të intensifikojmë dhe të kemi një dialog të vazhdueshëm, intensiv dhe rritje të informimit e të konsultimit midis punëdhënësit dhe punëmarrësve, sepse kanë shumë nevojë për informacion të dyja palët.

Ka shumë situata ku vetë punëmarrësit neglizhojnë respektimin e kushteve të punës apo masave mbrojtëse në vendin e punës dhe kjo vjen për shkak të mungesës së informacionit dhe të rëndësisë që ka kjo në mbrojtje të tyre. Edhe kjo është një pikë shumë e rëndësishme dhe unë mendoj se duhet adresuar. Këto janë disa nga pikat kryesore që unë mendova t'i veçoj në këtë diskutim dhe besoj se kolegja ime mund të flasë diçka në lidhje me ngacmimet e dhunën në vendin e punës.

Grida Duma – Ju e keni sjellë raportin. Ne mund të organizojmë seanca përtej kësaj, sepse informacioni është shumë i gjerë. Le ta konsiderojmë këtë një nisje. Unë e shoh që ju keni një lloj dakordësie, së paku, në gjestikulacion me njëri-tjetrin për problematikat që ka dhe kjo është një nisje e mirë, se pjesë e gjuhës konfirmuese është edhe nga ana e institucioneve shtetërore dhe ju që e paraqisni problematikën.

Ju lutem, me piketa, cilat janë ngacmimet e vijueshme, përveç aksidenteve që trajtuat dhe bëjmë një përmbledhje të shkurtër të gjetjeve dhe mundësive për ta vijuar këtë tryezë të përbashkët!

Gentiana Hasalla – Për të mos u zgjatur më shumë, se Edisoni e tha qëndrimin e Qendrës për të Drejtat në Punë, theksoj se studimi kombëtar është hera e parë që bëhet në Shqipëri. Është

një studim shumë i rëndësishëm për ngacmimet dhe dhunën në vendin e punës. Është i fokusuar aty, por unë do të trajtoj vetëm disa gjetje kryesore.

Ju keni materialin e prezantimit dhe studimin për ta konsultuar më tej. Në gjetjet e këtij studimi ne kemi që 1 në 4 persona e percepton ngacmimin në vendin e punës, si një fenomen të përhapur në Shqipëri. Realisht, do të shikoni më pas që ka 84% të personave që mendojnë se nuk raportohet siç duhet ose kur duhet ky fenomen që ndodh.

Një pjesë e rekomandimeve tona dhe një pjesë e rekomandimeve të studimit veçanërisht ndajnë faktin që nuk kemi mekanizma ose punëdhënësit nuk kanë mekanizma të mjaftueshëm për ta bërë monitorimin dhe për të bërë referimin e rasteve të ngacmimeve e të dhunës në vendin e punës.

Në qoftë se këta mekanizma ekzistojnë, shumica e punonjësve nuk i njohin këta mekanizma ekzistues për të referuar rastet e ngacmimit dhe të dhunës në vendin e punës.

Një nga arsyet kryesore dhe një nga problemet kryesore, që përmendi edhe Edisoni, ishte komisioni i sigurisë dhe i shëndetit në punë. Shumica e personave kanë deklaruar, dhe këtu flitet për një pjesë të mirë të punonjësve që janë anketuar, se ato nuk e njohin dhe nuk e dinë që ka një komision për shëndetin në punë dhe nuk e dinë nëse ky funksionon apo jo. Pra, në rast se nuk kemi mekanizma mbrojtës për punonjësit, në momentin që ata kanë një rast dhune apo ngacmimi në punë, i cili ndodh jo vetëm nga ana fizike ose nga ana verbale, por flitet edhe për dhunë ekonomike, ata nuk dinë se ku ta referojnë këtë rast.

Është shumë e rëndësishme që ne si organizatë e shoqërisë civile, në bashkëpunim me institucionet, me inspektoratin, me institucionet e shëndetësisë, dhe është mirë të bëjmë, së pari, informim dhe ndërgjegjësim shumë të mirë në vendin e punës, të rritim bashkëpunimin me organizatat e punëdhënësve, por, mbi të gjitha, duhet të kenë mekanizma të ngritur dhe funksionalë, të cilët i shërbejnë për të referuar rastet e dhunës dhe të ngacmimit që ndodhin në vendin e punës.

Grida Duma – Për parantezë, kam një ndërhyrje. A janë konsideruar vend punë universitetet?

Gentiana Hasalla – Nuk është një nga sektorët që është marrë në studim, por patjetër që janë një vend pune.

Ne mendojmë që ky studim, që është bërë për herë të parë, ka nevojë të ndiqet nga studimet e tjera që përfshijnë të gjithë sektorët e punës.

Grida Duma – Nuk e kam fjalën vetëm për stafin akademik, e kam fjalën edhe për ambientin studentor.

Gentiana Hasalla – Jo, nuk është marrë në studim, por ne mendojmë që është një pikë shumë e mirë për t’u marrë në studim.

Ne kemi marrë sektorin e arsimit dhe në sektorin e arsimit ka dalë një përqindje, 62%, që mendojnë se ka ngacmime dhe dhunë në marrëdhëniet e ndërvarësisë. Janë marrë mësuesit dhe pjesa e sektorit akademik në studim dhe 62 prej tyre mendojnë se ka ngacmime e dhunë në marrëdhëniet e ndërvarësisë.

Grida Duma – Kur i referoheni dhunës ekonomike, ma saktësoni, ju lutem!

Gentiana Hasalla – Veçanërisht dhunës ekonomike, e cila është një fenomen pak i njohur ose pak i diskutuar, që i referohet faktit që punonjësit deklarohen se paguhen më pak në krahasim me punën që bëjnë. Ata punojnë më shumë orë nga ç’janë realisht të paguar.

Këtu përfshihen 6 sektorët që janë marrë në studim: arsimit, shëndetësia, fasonet, *call center-at*, të cilët vuajnë realisht nga dhuna ekonomike. Së fundi, sindikata e punonjësve të *call center-ve* arriti dhe bëri të mundur që atyre t’u paguhen ditët e pushimit në të cilat ato punojnë dhe nuk u janë paguar kurrë më parë. Është një dhunë ekonomike e një lloji fakti që nuk paguhen për ditët e pushimit në të cilat punojnë.

Grida Duma – Në këtë përcaktim a përfshihet korrupsioni, pra paratë e dhëna për të fituar një vend pune?

Gentiana Hasalla – Jo, veçanërisht, sepse si dhunë ekonomike ne e përcaktojmë me faktin e asaj që vuan punëmarrësi nga punëdhënësi ose nga institucioni. Në qoftë se përfshijmë çështjet e korrupsionit, aty futemi në çështje penale.

Grida Duma – Si e perceptojnë të anketuar, është ideja?

Gentiana Hasalla – Ne kemi edhe doktor Stronin këtu, që është kryetar i sindikatës së punonjësve të shërbimit shëndetësor. Ka dalë një përqindje interesante për t’u diskutuar, fakti që dhuna që pësojnë këta punonjës të shërbimit shëndetësor nga të tretët, pra 60% e të anketuarve nga ky sektor deklarojnë se kanë pësuar dhunë nga personat e tretë, (pacientët, familjarët).

Grida Duma – Urdhëroni, doktor!

Genci Stroni – Në fakt, unë do të doja të bëja një analizë të gjithë asaj që ne i themi shëndetësi, por, për të qenë më konciz, do të duhet të fokusohem vetëm në piketat kryesore që të ndihmojmë edhe punën e komisionit.

Nëse ne flasim për shëndetësi, do të duhet të kemi parasysh infrastrukturën, do të duhet të kemi parasysh punonjësit që punojnë në këtë infrastrukturë dhe shërbimi që ata japin.

Nëse fokusohemi pikërisht në secilin prej tyre, do të na duhet shumë kohë dhe jam i bindur që ju keni mundësinë që në aspektin tuaj politik, nga të dyja anët, pozitë dhe opozitë, ju keni piketat tuaja dhe mënyrën se si ju e konceptoni, megjithatë në aspektin se si e konceptojnë ne pjesën e punonjësve shëndetësorë, ose si e ndjejmë ne problematikën, është ajo që tashmë është bërë publike dhe dihet fakti i largimit të pjesës më të madhe të punonjësve, njëkohësisht, ajo që shoh si problematike është një e ardhme pa krye, kur edhe studentët e mjekësisë apo infermierisë sot po studiojnë për të ikur jashtë dhe kjo është akoma më e dhimbshme.

Pse ndodh kjo, jam i bindur se ju e keni bërë analizën. Një prej problematikave kryesore është pagesa dhe trajtimi që i bëhet stafit mjekësor në vendin e punës. Nëse do të diskutojmë për këtë, nuk jemi vendi i parë i cili e ka pasur këtë lloj problematike. Të gjitha vendet e ish-Europës Lindore kanë pasur një situatë të tillë, por e kanë asimiluar shumë shpejt dhe kanë arritur të gjejnë mekanizmat, qoftë edhe ligjorë, për të bërë të mundur që ta zgjidhin këtë lloj problematike.

Po marr për shembull Rumaninë apo, nëse doni, edhe shtete të tjera, ku pas emigrimit të trurit mjekësorë, mjekëve përgjithësisht drejt Gjermanisë, u rikthyen në momentet e parë duke bërë krahasimin e pagave me Gjermaninë, rrjedhimisht, kjo bëri që të frenonte në masë largimin, por të bënte të mundur edhe kthimin e atyre që kishin emigruar. Pra, pagesa e stafit mjekësor është njëra prej piketave.

E dyta është mënyra se si konceptohet puna e një mjeku apo infermieri. Sigurisht, këto janë në aspektin e shërbimeve dhe janë shërbime shëndetësore shumë të domosdoshme, kur bëhet fjalë për njerëzit me paafësi të ndryshme, të përkohshme apo të përhershme, rrjedhimisht, një pjesë e mirë e popullatës kanë të afërmit e tyre, të cilët kalojnë në këtë kalvar.

Si do të duhej të ishte shërbimi shëndetësor? A është ky më i miri? A ndeshet punonjësi shëndetësor me problematika, të cilat nuk janë në dorën e tij për t'u zgjidhur?

Zakonisht mjekët janë ata, të cilët do të duhet t'u japin përgjigje pacientëve apo familjarëve edhe për letrën e tualetit në spital, sepse i kërkohet llogari mjekut për këtë, gjë që nuk është aspak në dorën e tij, por është pjesë e administratës, por nuk shkon kjo ankesë në administratë dhe kjo përbën një rritje të konfliktit më pas, si pasojë e këtyre ankesave dhe bën një rritje të konfliktit midis pacientit, familjarit të pacientit dhe stafit mjekësor. Këtu janë parë edhe elemente të dhunës dhe të kërkesës që ata kanë, duke qenë se nuk janë të plotësuara të gjithë ato çfarë një shërbim

dinjitoz mund të ketë dhe, si pasojë e kësaj dhuna në rastin konkret adresohet drejtpërdrejt te personeli shëndetësor.

Nëse flasim për kushtet dhe kriteret e këtij personeli, lidhur sigurisht edhe me emigracionin, por jo vetëm, unë do të thosha që, nëse ne diskutojmë për një përqindje mjekësh në shërbim të 1000 banorëve, jemi vendi i fundit në Europë, ku kemi 1.1 mjek për 1000 banorë dhe kjo mendoj se është deri diku problematike, pasi shton ngarkesën e një mjeku, por bën të mundur që shërbimi shëndetësor të mos jetë ai që duhet të jetë nga ky personel i cunuar. Rrjedhimisht, kjo përbën edhe rritjen e problematikave me të cilat ballafaqohet ky mjek apo ky staf mjekësor në shërbimin shëndetësor.

Duke e parë në këndvështrimin e shërbimeve dhe të kushteve me të cilat punohet, pra kushtet kur këto japin mundësinë e shërbimit, sigurisht që është bërë një punë që ka tendencën që gjërat të shkojnë pozitivisht, duke e parë teknologjinë si një ndihmesë, por nuk mendoj që është aq e mjaftueshme ose të themi kjo u arrit dhe pas kësaj çdo gjë është okej.

Patjetër që do të duhet të gjenden mekanizma që të realizohet ky lloj shërbimi në më të mirën e mundshme, gjithmonë duke marrë si prioritet pjesën e personelit shëndetësor, që të jenë ata primarë dhe çfarë ata kërkojnë në kushtet që ato veprojnë. Mos harroni, se gjatë pandemisë ne u ndeshëm me problematika, qoftë edhe elementare të mbrojtjes në punë, siç ishte mungesa e maskave, dorezave apo veshjeve (ky ishte momenti i parë i periudhës së pandemisë), por mendoj që tashmë, duke qenë se fituam një lloj eksperience (në aspektin qeveritar) dhe, detyrimisht, do të duhet të mos gjendemi sërish në situata të tilla, ku një ushtar shkon në luftë pa armë, gjë që u pa mes radhëve të mjekëve pati edhe viktima.

A u morën masa që të minimizohej numri i këtyre viktimave, ashtu sikurse shtetet Perëndimore një pilot e vlerësojnë aq shumë, mendoj që një mjek nuk vlen më pak se sa një pilot, sepse do të duhet një kohë e gjatë për të krijuar atë lloj eksperience?! Megjithatë, do të thosha që masat e marra për të minimizuar humbjen e jetëve nuk mendoj se kanë qenë aq sa duhet, sepse aty ku humbasin mundësitë tona të shërbimit, ose ato që ne nuk i promovojmë, ose nuk arrijmë t'i japim.

Sigurisht, kemi pasur mundësinë e marrjes së shërbimeve jashtë vendit, por aktualisht ky shërbim jashtë vendit përherë ka qenë i paguar prej vetë individëve, gjë që ka dëmtua xhepin e individit. Imagjinoni familjen, e cila ka pritur një person të afërt që ka ndërruar jetë dhe që, përveç të tjerash, ka pasur edhe një koston ekonomike shumë të lartë dhe vazhdon ta ketë barrë!

Imagjinoni më pas edhe fëmijët që do të rriten pa prindin, që ka humbur jetën gjatë pandemisë; mendoj se duhet të ketë një lloj ndihmese për këto familje.

Unë mund të zgjatem pa fund, por këto janë më kryesoret. Mendoj se mund të gjejmë pika të përbashkëta, jo vetëm me sindikatën, por edhe me organizatat e tjerë, të cilët mbrojnë punën e punonjësve.

Faleminderit!

Grida Duma – Faleminderit, doktor!

Qëndrimet tuaja janë shumë me vlerë për këtë tryezë dhe këtë komision dhe do të na kenin në disponibilitet dhe në mbështetje të plotë të një axhende që ndiqet me një lloj kalendari bashkërendimi, koherence politikash, ku ne mund të shtyjme dhe ta mbështesim procesin për të qenë të bashkërenduar aq sa mundet.

Është e qartë se kjo tryezë mban shumë, se 6 sektorë janë vetëm në studim, por janë më shumë se kaq. Ekonomia informale pa diskutim e rëndon dukshëm sigurinë në punë. Ndërgjegjësimi pastaj është element tjetër.

Vijojmë me zotin Prence.

Edvin Prenci – Përshëndetje, e nderuar kryetare!

Të nderuar deputetë,

Ne përfaqësojmë sektorin e fasonerisë dhe manufakturës, pra mbi 700 biznese të sektorit.

Bashkëpunimi për sa i takon inspektoratit të punës, por edhe përfaqësuesve të punëmarrësve për ne është shumë i rëndësishëm.

Duam të bëjmë ndryshimin me çfarë ka ndodhur ose çfarë është bërë në të kaluarën dhe ndryshimi, po nuk filloi nga ne, nuk mund të shkojmë në bazë ose nuk mund të përcillet tek të gjithë anëtarët tanë.

Mendoj se ka një përmirësim të kushteve dhe të sigurisë në punë. Patjetër që duhet të ecim me hapa të shpejtë, sepse koha nuk pret. Patjetër që ka edhe një ndërgjegjësim për sa i takon bashkëpunimit me institucionet dhe me elemente të tjera shumë të rëndësishme, por mendoj që, për sa u tha më përpara, ka një dallim me të kaluarën dhe duhet medoemos që ky bashkëpunim të çojë akoma më larg e më mirë, për sa i takon evidentimit të rasteve, po pse jo, edhe ne të dalim më krahun e kundërt, pra në mbrojtje të punëmarrësve në ato evente që ne do t'i shikojmë dhe do t'i gjykojmë se janë të drejta dhe duhet të bëhen shembull për të tjerët që të ketë një respektim të denjë të punës dhe të të gjitha kushteve të punës.

Faleminderit!

Florenc Zekja – Përshëndetje!

Unë jam Florenc Zekja, koordinator i Shoqatës “Pro-Eksport”

Në radhë të parë dua t’ju falënderoj, pasi është hera e parë që përfaqësuesit e biznesit të manufakturave vijnë për herë të parë në parlament, një event, duke shpresuar që të mos jetë vetëm për çështjen e sigurisë në punë. Ne kemi një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë si me Shoqatën e Grave, edhe me institucionet, por ajo që vëmë re ne dhe që është mjaft është e rëndësishme, është fakti që biznesi i manufakturave nuk është në listën e bizneseve me risk, për sa u takon aksidenteve në punë. Kjo normalisht nuk është se ka ardhur për një ditë, por ka ardhur si rezultat i një bashkëpunimi të vazhdueshëm, nëpërmjet dialogut, herë pas here edhe me penalitete...

Grida Duma – Cilën shoqatë përfaqësoni ju?

Florenc Zekja - Veshjet dhe këpucët.

...dhe t’ju them të drejtën në këto momente duhet të jemi krenarë që raportojmë para jush, sepse është një biznes, i cili nuk është ashtu siç është paraqitur nëpër media, por është një biznes i kontrolluar. Po ashtu, më duhet t’ju them sa u takon kushteve të punës, organizatat dhe institucionet e ndryshme i kanë parë edhe vetë që nuk janë më ato të 10 vjetëve më parë, por janë biznese bashkëkohore, të cilat raportojnë jo vetëm përpara organeve shtetërore edhe para auditeve të huaja (nuk e di a jeni në dijeni), pasi klientët tanë kryesorë janë italianë dhe gjermanë, duke i pritur çdo 6 muaj nga këta. Ne duam të jemi në rregull si me shtetin ashtu edhe me të huajt.

Sa u takon studimeve, mendoj që këto studime, që ju i keni para, por edhe studimi kombëtar lënë shumë për të dëshiruar, sepse në momentin kur këto studime bëhen pa bashkëpunimin e biznesit, rezultati nuk del i saktë. Kam edhe diçka tjetër sa u takon këtyre studimeve, pasi kanë disa shifra alarmante dhe kushdo do t’i dëgjonte në televizor nëpër shtëpi do të tronditej. Në këto studime thuhet që 64% e të punësuarve pësojnë dhunë psikologjike, seksuale dhe ekonomike. Më duhet t’ju them se rreth 70% ndërmarrjeve që ne drejtojmë drejtohen nga gratë, ne e kemi biznes familjar, unë dhe Edvini, që jemi të pranishëm këtu, pra biznesi ynë drejtohet nga gratë tona. Nuk arrij ta kuptoj si mund të jetë ky informacion që 64% e grave dhunohen, kjo është një shifër shumë e frikshme, prandaj dua t’i qetësoj të gjithë shqiptarët, burrat dhe djemtë e këtyre grave që kjo gjë nuk është e tillë, madje nuk ekziston.

Pra, i bie që në 100 punëtorë që unë kam në 64 prej tyre të ushtrorë dhunë, sepse gruaja ime nuk mund t’i ngacmoj seksualisht.

(Diskutime pa mikrofon)

Nëse është bërë në nivel kombëtar në rregull, por jam duke folur për biznesin që unë kam. Dua të di se me cilin grup biznesi është bërë ky studim...

(Diskutime pa mikrofon)

Një sekondë, ta mbaroj fjalën, sepse ti the nuk do të zgjatem dhe u zgjate.

...dhe me cilën organizatë është bërë? E para.

E dyta, pyetësi ku është bërë në ndërmarrje, në rrugë?

Nëse e keni këtë informacion, ju duhet ta dini që biznesi i manifakturave nuk është në listën e bizneseve me risk në punë. Aksidentet që ndodhin në punë në këtë biznes janë të tipit shpoi gishtin me gjilpërë, preu gishtin me gërshërë, aksidente që u ndodhin grave tona edhe në shtëpi, pra nuk mund t'i quash aksidente në punë. Unë kam përshtypjen që ju duhet të jeni më rigoroz dhe të saktë, sepse ajo që jepni ju, madje keni harxhuar edhe para për të bërë këtë studimin, por më tepër dalja në televizione dhe të thuash që 64% e punëtorëve dhunohet, është diçka absurde, prandaj duhet të jeni shumë të kujdesshëm dhe ta bëni në bashkëpunim me...

Grida Duma – Së pari, i nderuar i ftuar, ju do të jeni të ftuar gjatë gjithë kohës në komision për çështjet tuaja, për më tepër për çështje që e prekin këtë komision, pa asnjë diskutim, mjafton që ju të keni vullnetin të merrni pjesë dhe të përfaqësoni interesat tuaja, të punonjësve dhe të grupimit tuaj si grupim biznesi.

Së dyti, pyetjet në këtë komision merren shënim dhe pastaj mënyra dhe dhënia e përgjigjes moderohet nga ne dhe nga përfaqësuesit e votës, që janë kolegët deputetë.

Nuk është e nevojshme t'ju bëj me dije se çfarë parametrash ka një studim të nivelit kombëtar, është marrë apo nuk është marrë përfaqësia juaj, mundet që jo, por ju keni gjithë të drejtën tuaj të thoni që ky studim nuk na përfaqëson, sepse edhe mund të ndodhë brenda një studimi kombëtar, cilido qoftë, ka një fokus dhe nuk e përfaqëson kurrë realitetin 100%. Për këto arsye nëse ka pyetje për studimin, padyshim ato do të nisin nga deputetët dhe më pas do të vijojnë me ju, por të gjitha duhet të merren shënim dhe mbi qartësinë dhe mbi ndryshimin ndoshta të metodologjisë se cilat janë kriteret kur bëhet metoda e një studimi ne këtu jemi dhe do ta diskutojmë.

Në mbështetje të një trajektoreje që ju ngrini, herë pas here kam edhe unë një qasje timen, por kjo është e secilit në fund të ditës dhe nuk përfaqëson institucionalen domosdoshmërisht, që po, biznesi atakohet më shumë se duhet në Shqipëri dhe paragjykohet për shkak të një kulture të

përgjithshme në të cilën presupozohet që biznesi shfrytëzon punonjësit, siç është e qartë që është e pamundur për shtetin t'i mbrojë totalisht të drejtat e punonjësve aq më tepër, po e diskutoja edhe me kolegen këtu, ku rreth 50% e ekonomisë është informale dhe që nga ky moment problemet janë shumë të mëdha, ashtu siç ka edhe një kulturë të përgjithshme të vendeve ish-komuniste që biznesi shihet me lupë jopozitive. Këtë e ndaj me ju, sidomos si një përfaqësuese e një partie të djathtë, sepse për ne biznesi është motori ekonomik dhe motori ekonomik është gjithçka në fund të ditës, sepse është mirëqenia e qytetarëve. Të dyja këto qëndrojnë padyshim, por duke respektuar mënyrën se si do t'i zgjidhim këto pa shkuar tek asnjë paragjykim, sepse ndoshta nuk ka pasur, mund të ndërrojë terminologjia, ne këtu do të jemi dhe do ta bëjmë pjesën tonë për t'i mbështetur.

A ka ndonjë gjë tjetër për ta vijuar dëgjesën?

Po, Mirela.

Mirela Arqimandriti – Përshëndetje!

Ju falënderoj për këtë dëgjesë!

Të nderuar deputetë,

Të nderuara Grida dhe Klodiana,

Nuk është hera e parë që unë vij në parlament për këtë çështje, sepse kam ardhur disa herë që kur e kemi filluar veprimtarinë tonë para 8 vjetësh për të diskutuar dhe t'ju them të drejtën unë ndihem shumë mirë që ju e ribëni këtë aktivitet, si dhe me përfaqësuesit që janë të pranishëm. Pse? Me Florin dhe Edvinin jemi bërë miq, jo se dikur kemi qenë armiq, por ndërkohë që ne kishim një zë kritik sa i përket qasjes së bizneseve ndaj grave dhe vajzave punëtore në fabrikat e tekstileve dhe këpucëve, kishim ato gjetjet tona vit pas viti, për shkak se ne i takojmë realisht dhe flasim me to.

Tashmë dyert i kemi të hapura dhe trajnimet i bëjmë në bashkëpunim, duke folur për sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe bëjmë studime përkatëse në disa fabrika së bashku me gratë dhe këshillat e sigurisë dhe të shëndetit në punë, për të cilat kam ato problematikat e mia për sfidat që ato kanë. Kjo është diçka pozitive.

Nga ana tjetër kemi Inspektoratin e Punës me të cilin që nga viti 2019 kemi një marrëveshje. Unë jam shumë e gëzuar që Irida na lajmëroi për një krehje të sektorit, megjithëse zotërinjtë janë prezentë, jam duke folur vetëm për tekstilet dhe këpucët, sepse kam eksperiencë shumë në këtë sektor, sepse punojnë fort me gratë për ndërgjegjësimin e tyre, ndërkohë që Inspektorati së bashku me ne ka bërë një fushatë ndërgjegjësuere brenda fabrikave me vendosjen

e posterave, informacion të dhënë me gojë e të tjera. Pra, dua ta nis nga një situatë pozitive t'ju them të drejtën dhe është diçka mjaft e mirë që ky sektor po shihet.

Nga pikëpamja statistikore Instituti i Statistikave, është një vërejtje që e kam bërë gjithmonë, por do ta bëj edhe tani, nuk ka një ndarje të përcaktuar qartë përveç një studimi që kanë bërë Shoqata “Pro Eksport Albania” në vitin 2014, sa fabrika këpucësh dhe tekstilësh kemi në Shqipëri, cilat brende punojnë në Shqipëri dhe sa gra dhe burra janë punësuar përkatësisht në secilin prej tyre? Duke qenë se Instituti i Statistikave nxjerr studimin e përvitshëm për gratë dhe burrat, në total quhet manufakturë, pra nuk ndahet tekstile dhe këpucë, por u bashkohet ndërmarrjeve të tjera që bëjnë prodhime të ndryshme bujqësore, kështu që nuk e kupton sesa veta ka në punë sektori. Kjo gjë pengoi që të dihej se çfarë ndodhi me sektorin gjatë pandemisë. Një herë thanë që dolën 60 mijë gra pa punë, një herë 30 mijë, pra janë këto shifrat e çuditshme, të cilat çorientojnë edhe publikun, edhe vendimmarrësit.

Po përqendrohem tek tema për të mos ju ngrënë kohën edhe juve, kam këtu diçka që e kam përgatitur për ju me pika, por ju i keni marrë edhe dy studimet tona, ku njëri është i vitit 2019 dhe ribotim i vitit 2021...

(Diskutime pa mikrofon)

I kujt, i SLR-së?

(Diskutime pa mikrofon)

Unë përfaqësoj një tjetër organizatë, qendrën “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, kam qenë themeluese e qendrës së tyre dhe anëtare e bordit dikur, por tani nuk jam më, ata janë më vete, pra janë studime të ndryshme.

Studimin tim ju e keni nëpër *e-mail*-e, apo jo Egla?

Studimin “Diskriminimi me bazë gjinore në vendin e punës” dhe studimin “Për sigurinë dhe shëndetin në punë në fabrikat e tekstileve”, i cili sapo është lançuar.

Do t'ju them disa gjëra, por ajo që është më e rëndësishme, nuk do të zgjatem fare te gjetjet, është që duke u mbështetur në nenet 78 dhe 83 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 1, thuhet: “Shëndeti dhe siguria në punë garantohen nga ligji “Për sigurinë dhe shëndetin në punë””. Ju si parlament nuk keni bërë asnjë lloj vlerësimi të situatës dhe të impaktit se çfarë ka ndodhur me ligjin “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, kështu që një nga kërkesat e mia ishte që ju të bënit të vlerësim sa i takon ligjit “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Kanë kaluar gati 12 vjet që ky ligj është në fuqi, prandaj mendoj se do të ishte diçka shumë e mirë që ju ta vlerësonit, pasi do të ndihmonte në diskutimin që do të bëhej këtu në lidhje me këtë.

E dyta, çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë rekomandohen nga Konventat e Organizatës Botërore të ILO-s me nr. 155 dhe rekomandimi nr. 164, kështu që patjetër ky impakt duhet parë edhe në këtë këndvështrim.

Ju falënderoj që ju miratuat Konventën C 190 të ILOS-s dhe nuk e di se si do të fillojë funksionimi i saj këtu në Shqipëri, por di që kanë filluar disa takime, trajnime e gjëra të tjera, por nuk e kam të qartë se si do të funksionojë. Nga ana tjetër, mendoj që qeveria shqiptare duhet ta shohë dhe të zbatojë legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punë për t'u përafuar me direktivat e Bashkimit Europian, si dhe të marrë masa sa më parë për arritjen e indikatorit 8,8 të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm për garantimin e mjediseve të sigurta të punës për të gjithë punëtorët deri në vitin 2030. Puna që po bën tani Inspektorati i Punës me fabrikat e tekstileve ndikon në garantimin e indikatorit 8,8.

Studimet tona janë të shumta, por do të doja t'ju përmendja vetëm disa prej tyre, siç është ai që lidhet me diskriminimin në punë. Për shembull, te studimi i fundit që ju e keni nëpër *e-mail*-e, gratë raportojnë më tepër se burrat, sepse janë përballur me pyetje diskriminuese në intervistat e punës, për shembull rreth planeve për t'u martuar, 45% e tyre, për ngacmimin seksual në vendin e punës, 23% e të anketuarve tanë janë përballur me të paktën një formë të ngacmimit seksual në vendin e punës, si dhe nuk ka dallimi midis gjinive, sepse ne kur bëjmë studimet, shohim edhe opinionet e të dyja palëve.

Kemi një problem me lejen e lindjes në vendin e punës, pasi 13% të grave që kanë qenë shtatzëna u është mohuar e paguar e lindjes dhe ato nuk janë paguar dhe nuk kanë përfituar ndihmë shtetërore gjatë lejes së lindjes, si dhe 40% prej tyre treguan se u është ushtruar presion për t'u kthyer më shpejt në vendin e punës.

Edhe me kontratat e punës kemi një problem, ku 29% e grave dhe 19% e burrave deklarojnë që nuk kanë një kontratë pune. Gjithashtu, një problem i madh ka të bëjë me faktin që gratë dhe burrat në Shqipëri, sidomos në sektorin privat, nuk e njohin kontratën e punës, pra nuk kanë një gjë të shkruar që ata ta shohin, firmosin dhe atë e mban departamenti ose pronari.

(Diskutime pa mikrofon)

29% gra dhe 19% burra.

Edhe ky është një studim kombëtar që ne kemi bërë për diskriminimin në vendin e punës.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, nuk e kemi ndarë, sepse ka qenë një studim, i cili nuk e ka pasur ndarjen e sektorit privat apo publik, por më shumë donim të nxirrnim se si është diskriminimi me bazë gjinore në vendin e punës.

Disa rekomandime të ndryshme që mund t'ju themi janë përfundimi i procesit për direktivat individuale të Bashkimit Europian për sigurinë dhe shëndetin në punë, kjo është e domosdoshme; analiza për sigurinë dhe shëndetin në punë; futja e një mekanizmi ligjor për përgatitjen dhe certifikimin e ekspertëve të shëndetit dhe të sigurisë në punë në kompani, mendoj se edhe ata që punojnë me pronarë e kanë problem këtë, sepse u kërkohet edhe nga kontraktorët e tyre të huaj; kompanitë duhet të punësojnë mjekë të licencuar, nuk kemi mjekë të licencuar në kompani; duhet të vlerësohen kualifikimet dhe referencat e mjekëve (ndoshta zotëria që merret me këtë çështje mund të na thotë diçka); të ngrihet një sistem për fillimin, trajtimin e vazhdueshëm dhe trajnimin e inspektorëve të punës; të plotësohen vendet vakante, e kemi nxjerrë edhe ne, si dhe të edukohen pronarët e bizneseve dhe stafi administrativ në lidhje me çështjet e të drejtave në punë, Kodit të Punës dhe të sigurisë dhe të shëndetit në punë, pasi nuk ka një gjë të tillë.

Unë këto kisha për t'ju thënë, gjërat e tjera ju i keni nëpër *e-mail*-et tuaja, të cilat pasi t'i lexoni mund t'i diskutojmë më vonë.

Faleminderit!

Grida Duma – Faleminderit!

Vazhdojmë me kolegët deputetë nëse kanë pyetje apo sugjerime, pasi më vonë do të kemi dëgjesën tjetër.

Zoti Vasili.

Petrit Vasili – Do t'ju flas shkurtimisht. E vetmja gjë për të cilën ne nuk hodhëm dot dritë sa duhet në lidhje me këtë çështje, kjo nuk është sot, por po bartet vit pas viti, sa herë flasim në mënyrë të veçantë për shëndetin në punë, gjëja, e cila për fat të keq është shndërruar në një strukturë raportimi fiktiv dhe joreal është çështja e shëndetit në punë dhe të atyre që rëndom dikur quheshin “sëmundje profesionale” dhe sot quhen “shëndet në punë”, 15-20 vjetët e fundit. Reduktimi i raportimeve thjesht dhe vetëm për aksidentet në punë pa shumë patologji dhe probleme që lidhen me sëmundjet profesionale, kush e njih mirë fushën e di, unë me formimin profesional e kam një fushë që jam marrë gjithë jetën, është zanafilla e shumë problemeve patologjike, që janë mijëra e mijëra njerëz që punojnë pikërisht për këtë problematikë.

Besoj që në rast se kemi shumë gjëra, të cilat mund t'i disiplinojmë fort, mund të marrim provendimente ligjore, patjetër mund të kemi edhe rezultate të mira, të jeni të bindur që në këtë pikëpamje hallkat që nga ato që e ndjekin këtë çështje në nivel universitar, por edhe më tutje në nivel kapilar, kanë pësuar një këputje të jashtëzakonshme. Të themi çfarë të duam, por jeta e këtyre punonjësve praktikisht shkatërrohet, jetëgjatësia e tyre kompromentohet, jeta e tyre me kualitet shëndetësor komprometohet rëndë dhe ata që janë klientis e dinë shumë mirë që kur thellohen shumë në gjetjen e themelit të mjaft sëmundjeve të të gjitha sistemeve respiratorë, kardiovaskularë, lokomotorë në mënyrë të veçantë e të tjera, në themel të tyre ka qenë pikërisht një ndjekje e keqe ose më mirë një mosndjekje e problemeve të sëmundjeve profesionale.

Nëse ka një apel që unë mund të bëj, jo si deputet, por në emër të profesionit, në rast se duhet të bëjmë një gjë nga e para është pikërisht ndjekja e sëmundjeve profesionale. Është një situatë që ka dalë dhe po del nga duart, me shumë të drejtë sipërmarrësit thonë që bëjnë më të mirën, por kjo nuk mjafton absolutisht, sepse edhe në të gjithë botën ku ka aplikim teknologjish dhe punë të nivelit shumë të lartë kjo problematikë ndiqet me një rigorozitet të jashtëzakonshëm teknik dhe shkencor.

Të jeni të bindur që edhe pesha mbi shëndetin publik, mbi shpenzimet publike, por edhe mbi të ardhmen jo të mirë shëndetësore të shumë punonjësve e ka burimin këtu. Në rast se do të duhej të bënim jo thjesht një dëgjësë, por t'i futemi kësaj problematike me themel, të jeni të bindur se do t'u bënim një shërbim shumë të mirë. Në rast se për çështjet e tjera mund të arrihet një ndërgjegjësim shoqëror shumë i fortë, patjetër që mund të arrihen rezultate edhe në drejtim të diskriminimit, stigmës apo ngacmimit e të tjera, ndërkohë që këtej zhvillohet një dëm sistematik i përditshëm, sepse duhet ta dini që edhe kontrollohet mbi lëndët e para që vijnë dhe mbi dëmet shëndetësore të tyre, në kohën e sotme, më vjen keq që po e them, nuk janë as 1/5 apo 1/10 e asaj që ndiqej para viteve 1990.

Unë kam punuar si specialist i asaj fushe në atë kohë dhe e di që materialet e para që hynin në industri verifikoheshin gjerë e gjatë, përveç kontrollit të të sëmurëve profesionalë e të tjera. Ata që janë mjekë me eksperiencë dhe e njohin situatën e dinë që kjo situatë është jashtë kontrollit.

Unë mendoj që edhe organizatat joqeveritare, të cilat me shumë përkushtim dhe pasion janë marrë me këtë fushë do të na ndihmonin shumë që edhe ato të krijojnë një ndjeshmëri të madhe për këtë problematikë, sepse do të kemi praktikisht, po marr në mënyrë të veçantë gratë, të

cilat nuk do të diskriminohem më, sepse marrim punë të barabartë, por marrin një punë shëndetësisht të dëmshme dhe shëndetin nuk ua rikuperojmë dot më kurrë.

Dikush mund të më akuzojë për një qëndrim më shumë medikal sesa social në këtë mes, por jashtë optikës së një shëndeti të mirë, afatgjatë, i cili zhvillon edhe përgjegjësitë brenda familjes dhe shoqërisë, nuk mund të dalim dot. Të gjitha këto ju thashë për t'ju tërhequr vëmendjen.

Faleminderit, zonja kryetare!

Grida Duma – Faleminderit, zoti Vasili!

Në qasjen time është e drejtë të fillosh me medikalin dhe pastaj me socialin pa asnjë diskutim dhe besoj se me këtë bien dakord edhe të ftuarit dhe përfaqësuesit e grupeve të ndryshme.

A ka pyetje të tjera?

Po, zonja Spahiu.

Klodiana Spahiu – Faleminderit, kryetare!

Në fakt, është hera e dytë që e dëgjoj studimin, pasi kam qenë pjesë edhe në takimin ku ju keni shpalosur të dhënat e studimit. Ka disa gjetje që, ndoshta kampioni duhej të ishte pak më i madh në numër për të qenë ndoshta edhe pak më të saktë, por ne nuk e gjejmë dot. Ne po studiojmë të dhënat që ju keni sjellë si studim kombëtar. E vlerësoj, është studimi i dytë. Zonja Mirela ka ardhur në komision në mënyrë të vazhdueshme dhe ka prezantuar të dhënat e një studimi të mëparshëm të bërë në nivelin e fasonërive, ndërsa është hera e dytë që vjen një studim i tillë. Unë e vlerësoj pozitivisht si hap të parë dhe angazhim më të madh të shoqërisë civile për të mbështetur të drejtat e punëmarrësit. Megjithatë nuk duhet parë thjesht si mbështetje, por si bashkëpunim dypalësh midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. E vlerësoj shumë të drejtë sugjerimin që dha Mirela për të rivlerësuar edhe një herë ligjin për shëndetin në punë, sepse tashmë kanë kaluar shumë vite dhe ne si komision e kemi filluar një procedurë të tillë, me mbështetjen e OSBE-së për ligje të tjera, por do të ishte shumë mirë ta bënim edhe këtë gjë me ligjin për shëndetin në punë.

Ne vendosëm ta bëjmë këtë seancë dëgjimore, sepse e kemi bërë edhe herë të tjera, por sot donim ta bënim bashkë, siç janë bërë, inspektorati së bashku me shoqërinë civile, së bashku me një pjesë të sindikatave dhe menduam se zoti Stroni do të ishte përfaqësues i sindikatave për mjekët për shëndetësi. Problematikat që ngriti zoti Stroni mund t'i diskutojmë dhe në një tryezë tjetër, në një mbledhje tjetër, por unë e vlerësoj angazhimin e sindikatës së shëndetësisë sepse ato

problematika që ngrihen për shëndetësinë t'i ndajmë të gjithë bashkë si komision por edhe me ministrinë, sepse pa një bashkëpunim të vazhdueshëm unë mendoj se nuk do të kemi përmirësim të situatës. Unë e kujtoj studimin e zonjës Arkimandriti. Në vitet 2017-2018 ka qenë një situatë shumë e rëndë, studimi ka qenë si nxitje dhe shkak për ne që të kryenim disa vizita në disa fasonëri edhe individualisht. Na ndodh shpesh ne deputetëve që fushatat të na bëjnë të dalim më shpesh për të shkuar dhe për të parë fasonëritë. Kjo është e vërteta, sepse po të mos ishin fushatat nuk do t'ju kishim vizituar aq shpesh, por ky është gabim. Situata ka ndryshuar, kemi parë kushte pune me ndryshim shumë të madh. Po nuk është vetëm kjo, ajo që nënvizoi zoti Vasili shumë vite më parë ka pasur një lëndë të veçantë në Fakultetin e Mjekësisë që merrej me sëmundjet profesionale. Duhet të ketë një vendim të Fakultetit të Mjekësisë për një vlerësim edhe më të thellë të sëmundjeve profesionale. Kur unë kam qenë studente, e kujtoj se ka qenë një pavijon i tërë me të sëmurë të prekur nga mushkëritë për shkak të punës në miniera. Por tani ka ndryshuar komplet edhe forma, dhe sëmundjet që mund të ndodhin në punë. Unë sot e vlerësoj dhe insisto që mjeku që ju keni duhet të bëjë një vlerësim edhe më real, sidomos në ato ndërmarrje ku ka shumë zhurmë, ku ka dëmtim të dëgjimit, në ato ndërmarrje ku është një pozicion i detyruar i qëndrimit, siç janë fasonëritë. Unë mendoj se Komisioni i Shëndetësisë duhet ta zgjerojë gamën e çështjeve, sepse përveç pjesës së sigurisë në punë është edhe shëndeti në punë. Mund të bëjmë edhe seanca të tjera në vazhdimësi për pasojat që mund të kenë në shëndet dëmtimet në vendin e punës.

Unë ju mbështes si nismëtar të një OJQ-je që po merret me sigurinë dhe shëndetin në punë. Jam skeptike për sa u përket shifrave, megjithatë do t'ia lëmë kohës dhe duke përfshirë më tepër profesione që mund të kemi rezultat që të jetë më real.

Faleminderit!

Irida Qosja- I gjithë personeli i Inspektoratit të Punës, me përjashtim të shërbimeve rregullohen me statusin e nëpunësit civil dhe vendet vakante janë lëvizje të punëmarrësve. Kemi pasur edhe largime nga puna të inspektorëve me masa disiplinore, por që procedura e rekrutimit kërkon një kohë të caktuar. Aktualisht janë të shpallura dhe janë në fazën e plotësimit, por që edhe plotësimi i vendeve vakantë do kohën e vet. Edhe në momentin që emërohet një inspektor do një kohë të caktuar të futet në inspektim, sepse kërkon trajnime të vazhdueshme.

Grida Duma- Kjo shifra 116 tregon organi gramën për të gjithë Shqipërinë.

Irida Qosja - Janë 165 për të gjithë Shqipërinë.

Grida Duma – Po pse janë 20 vakanca kur thoni se ka 94 inspektorë?

Irida Qosja – 94 janë inspektorët e terrenit, 165 është e gjithë struktura ndërkohë 21 janë inspektorë në drejtorinë qendrore. Dhe vakancat janë të shtrira në të gjithë strukturën.

Grida Duma- Kjo shifër 165 për inspektorët, e mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë?

Irida Qosja – Ka diskutime për shifrën. Teorikisht nuk është se kemi një indeks të saktë për të marrë numrin e inspektorëve që duhen për densitet. Ka një shtesë personeli prej 11 inspektorësh, është bërë një shtesë në vitin 2020 me strukturën e re.

Në fakt, ne po përpiqemi që të përmirësojmë cilësisht kontrollin, pra të targetojmë subjektet që janë problematike në zbatimin e ligjit dhe për këtë kemi ndërtuar sektorin e analizës së fiskut dhe po investojmë mirë në aspektin e programimit të inspektimeve.

Grida Duma- Pra, të gjithë thoni se sa i takon mjekut të punës nuk ka një mjek të trajnuar, çështja që ngriti dhe zoti Vasili. Pse është e vonuar çështja e mjekut të punës?

Eda Beqiri- Ligji e ka të përcaktuar, që pavarësisht numrit të punonjësve, duhet të ketë mjek ndërmarrjeje. Të gjithë subjektet e kanë, në fakt, sot mjekun, por që në momentin që rekrutohet nga vetë punëdhënësi mjeku i ndërmarrjes, atëherë ai do të bëjë se çfarë i thotë punëdhënësi i vet. Kështu që analizat kryhen. Të ndara sipas ligjit janë: për subjektet që kanë risk të lartë është një herë në vit kontrolli periodik, por nuk është kusht i domosdoshëm, për fazonët është një herë në dy vjet, por që mjeku i ndërmarrjes ka disa detyra, jo vetëm kontrollin periodik, por edhe përshtatjen me vendin e punës për sëmundjet që mund të ketë një punëmarrës. Mjeku i ndërmarrjes është mjek i përgjithshëm, sepse sipas legjislacionin nuk kemi mjek pune sot për sot, sepse mungon në Fakultetin e Mjekësisë dega e Mjekësisë së Punës. Të gjithë mjekët që janë të licencuar nga Urdhri i Mjekut, por janë mjekë të përgjithshëm janë mjek pune. Në shumë vende të Europës mjeku i punës është i punësuar nëpër institute dhe ka disa ndërmarrje nën kontroll. Pra, paguhet nga shteti dhe janë të punësuar mjek pune të mirëfilltë.

Grida Duma- Par ka disa probleme. Së pari, sipas jush, duhet të jetë dega në Fakultetin e Mjekësisë që ta sigurojë si specialitet të veçantë. Këtë mungesë mund ta raportojmë edhe për 10 vjet dhe nuk ndodh asgjë. Ju besoj se e kuptoni se pse, sepse me diagnostikimin dhe lënien aty të problemeve vazhdohet gjatë. Për çdo sektor të ekonomisë, që ka një specifike të caktuar, dihet se cilat janë diagnozat nga të cilat rrezikohen punonjësit. A bëhet kontrolli për cilësinë e punës nga mjeku i punës?

Eda Beqiri – Sigurisht që bëhet kontrolli për cilësinë e punës, sepse është edhe një inspektorat tjetër. Inspektorati i Punës Kontrollon a ka mjek pune apo jo dhe a kryhen

diagnostikimet periodike, vizitat mjekësore, por ka edhe një inspektorat tjetër që është Inspektorati Shtetëror Shëndetësor që kontrollon cilësinë e shërbimit të mjekut të ndërmarrjes.

Grida Duma- A ka një raport të kontrollit në dijeninë tuaj? Apo ju nuk i kryqëzoni të dhënat me ata?

Eda Beqiri- Jo.

Grida Duma- Pse?

Eda Beqiri- Në fakt, ata janë në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa ne në fushën e Ministrisë së Financave. Realisht është një problem se ka mungesë të mjekëve të cilësisë, sepse ne në të dhënat tona mbështetemi në dokumentacion, ne e shohim në këndvështrimin nëse i mbulon me vizita mjekësore, a ka kartela mjekësore për çdo punëmarrës, a janë raportet mjeko- ligjore të fillimit të punës për çdo punëmarrës në dosje. Sigurisht këtu ne nuk jemi të pajtuar me situatën, por që duhet diskutuar edhe detyrimi ligjor që çdo subjekt të ketë një mjek. Efektivisht është i pamundur nga çdo subjekt për shkak se nuk mund të merren aq mjek në ndërmarrje. Kemi tentuar të kemi një listë të mjekëve të ndërmarrjeve. Do të thotë që në çeklistat që plotësojnë inspektorët e punës në një inspektim të caktuar, na rezulton se mjekët janë me kohë të pjesshme, përgjithësisht. Nëse bëhet një analizë del që një mjek e ka të pa mundur të ndjekë disa ndërmarrje.

Grida Duma- A e përcakton ligji sa ndërmarrje mund të ndjekë një mjek?

Irida Qosja – Po. Për subjektet me risk të lartë, për çdo 700 punëmarrës duhet të jetë një mjek ndërmarrje, ndërsa për subjektet me risk jo të lartë është që për 1500 punëmarrës duhet një mjek.

Petrit Vasili– Kur ngrita këtë çështje unë nuk e kisha fjalën thjesht për kabinetet e sëmundjeve personale, sepse u thjeshtua çështja e tillë. Ky problem ka është ndjekur që herët dhe ka pasur një rregull që në nivel lokal ka pasur kabinete të sëmundjeve profesionale, sepse gjetjet që mund të ketë një mjek, i cili mund të mbulojë edhe dy ndërmarrje nuk ka problem, janë shumë të vlefshme. Aktivitetet industriale janë të shumëllojshme dhe mënyra si orientohet hulumtimi për secilin është i ndryshëm dhe këtë e drejton mjeku specialist ose i shëndetit publik. Pra, unë e kam fjalën për një riorganizimi në nivel vendi, sepse dëmi shëndetësor është kaq i gjerë dhe i shtrirë sa asnjë nuk e ponderon dot.

Nga ndërhyrja e zonjës Spahiu u krijua ideja se bëhet fjalë për një shërbim të sëmundjeve profesionale në universitete. Jo, bëhet fjalë për një shërbim të shtrirë në tërë vendin që edhe puna e mjekëve që mbulojnë ndërmarrjet të mos jetë fiktive.

Tani për një moment t'i harrojmë përgjegjësitë. Ne mund të themi se po kjo ndërmarrje e ka mjekun, por ndërkohë atje konsumohet një dëm shëndetësor shumë i madh. Vihuni në këtë pozicion për të kuptuar se çfarë po them unë. Pra në dukje mund të shikoni njerëz të shëndetshëm, persona që duken të fuqishëm, por në momentin që t'i bën një ekzaminim dyshimi mjekësor i arsyeshëm, për çështje të sëmundjeve profesionale, mund të gjeni njerëz më një seri problemesh të mëdha. Të tëra industritë sot janë kaq të larmishme, për shembull sa i takon pozicionit të detyruar në punë fasonëria ka probleme shumë të mëdha. Po të shohësh sa i takon ankesave kanë prodhuar lloje- lloje rezultatesh, por të tëra industritë e kanë prodhuar këtë. Këtu kërkohet një rikonceptim i madh. Mund të mos e dëgjojë njeri këtë sot, mund të thonë që u thanë disa llafe, por dijeni se qarkullimi dhe akumulimi i dëmit shtetëror është shumë i madh, dhe, mbi të gjitha, kostoja që paguan shoqëria për ta rikuperuar është shumë e madhe, por njëkohësisht edhe mundësia e rikuperimit është shumë e vogël, sepse sëmundjet që vijnë nga puna, ngaqë dekursi i tyre zhvillohet për një kohë shumë të gjatë edhe dëmi shëndetësor është i thellë, nuk është lehtësisht i rikuperueshëm. Ndaj ky nuk është një shqetësim, për të thënë diçka, por është ndjeshmëri për ta rikonceptuar në tërësinë e vet, pasi kemi shumë inspektorate. Inspektorati Shëndetësor në mënyrën si funksionon sot është shumë larg kontrollit dhe vëzhgimit të sëmundjeve profesionale.

Struktura e dikurshme ishte kabineti i sëmundjeve profesionale, Instituti i Shëndetit Publik ishte sektor më vete, ishte pavijoni i sëmundjeve profesionale, ishte studimi i sëmundshmërisë periodik për të mbajtur situatën nën kontroll. Pse e bënte një regjim një partiak këtë punë? Sepse kërkonte të kishte kontrollin shëndetësor në kohë që kostot të mos rriteshin dhe të kishte mundësi që efektiviteti të ishte i lartë. Pra, ishte nisur nga një logjikë jo politike, por pragmatike për të pasur situatën nën kontroll.

Mirela Arqimandriti – Duke mbështetur zotin Vasili unë dua të them se në vitin 2019 organizata jonë organizoi një aktivitet në Suedi me një pjesë nga parlamenti i Shqipërisë ndër to dhe zonja Milva Ikonomi. Pamë këtë pikërisht që tha zoti Vasili. Vajtëm me qëllim dhe pamë këtë lloj strukture si ata merreshin me sëmundjet profesionale dhe pikërisht me qëllimin të mos kishin kosto të lartë sociale kur njerëzit fillonin të dilnin në pension, sepse e gjithë puna e gjatë në këmbë për shembull ose me pluhura të ndryshëm apo në miniera krijon problematika në shëndet. Ne kemi

hequr edhe kompensimin ushqimor të këtyre njerëzve. Faktikisht nuk përdoret më qumësht ku duhet patjetër të përdoren disa antidote. Suedezët e kishin një grafik të mirë ku tergoheshin sëmundjet profesionale në vende të ndryshme të punës. Ju duhet ta rishikoni si ta rithemeloni këtë strukturë, me një ligj ose akte nënligjore.

Faleminderit!

Florjan Zakja- Unë desha të bëj një sqarim. Në fasoneri helmet përdoren vetëm kur trajtohen copat ose lëkurat. Për fatin e mirë të shëndetësisë dhe fatin e keq tonin, sepse nuk kemi lëndë të para, në Shqipëri nuk prodhohet copë dhe as nuk trajtohen lëkurat. Po të thuash se janë toksike copat do të thotë se edhe veshjet që keni ju japin helmim, por ju garantoj dhe ju ftoj të vini në ndërmarrjet tona, ashtu siç kemi ftuar inspektoratet e tjera, të vini e të shihni për kushtet dhe çfarë trajtimesh bëhen. Në fasoneri nuk përdoren as helme dhe nuk ka as tymra. Fasoneria sjell sëmundje për shkak të qëndrimit 8 orë në një karrige, që është edhe sëmundja e një deputeti, ose probleme me shikimin, por punë me pesha dhe jashtë orarit nuk ka.

Petrit Vasili – Ne e trajtuam shumë qetë dhe butë këtë problem. Tani, miku im, po ta them me shumë mirësi, këtij arsytimit të fundit iu fute kot. Tani po të them një gjë personale nga unë, jo me të dëgjuar, kur bëja specializimin në Itali u gjetën me probleme shumë të mëdha linja që prodhonte Coco Chanell. Po ta shikoje nga jashtë ajo linjë ai ishte një laborator perfekt. Ama kur bëheshin analiza përmbajtësore të të tërë komponentëve kishte problematika. Cilat janë pasojat e një pozicioni të detyruar? Për shembull cilat janë shkaqet e një pozicioni të detyruar me komoditet minimal? Mundësojnë abortet para kohe, pra problematika që lidhen me gjininë femërore, po marr si shembull gratë se për burrat kanë të tjera. Kështu që kjo është një punë komplekse. Sipërmarrësi bën më të mirën e vet dhe nuk jemi ne për të drejtuar sipërmarrësit, sepse përpiqet të krijojë maksimumin e kushteve. Tani ballë përballë me sipërmarrësin është eksperti që ka prioritet mbrojtjen e shëndetit dhe kërkon që ky apo ai element të mund të bëhet më i mirë, të përmirësohet këtu apo atje. Por kjo është një analizë profesionale. Pra, duhet të dini një gjë, mjeku i sëmundjeve profesionale ka një shprehje nëse një kardiologu i mjafton një traktat ose infeksionistit një libër, mjekut të sëmundjeve profesionale nuk i mjafton një bibliotekë, sepse duhet të studiojë kimikatet, korrentet e ajrit, posturën, mënyrën e pozicionit, këndet si rri trupi, sepse një kënd i caktuar pas 20 vjetësh bën që ai të mos lëvizë dot ose të ecë shtrembër. Pra, duhet të them se në këtë mënyrë ne duhet të ndihmojmë njerëzit, por edhe biznesin, sepse sa më shëndetësisht të aftë të jenë aq më

mirë do të jenë për punë e tyre dhe nuk do të paguajmë punë të papaguar, sepse nuk merren raporte mjekësore për paaftësi në punë dhe do të jenë të gjithë të lumtur dhe të kënaqur.

Edison Hoxha- Zoti Vasili, nuk i heq asnjë presje asaj çfarë thatë ne nuk presim institucionet, pra kur të vendoset, se, siç thatë edhe ju, sëmundjet profesionale janë shumë të rëndësishme, flasim për një sektor që ka rreth 75 mijë të punësuar, ku 95% janë gra. Për ne punonjësit janë aseti më i rëndësishëm. Ne nuk do të presim derisa të krijohen figurat profesionale të mjekëve profesionalë, por tashmë kemi nënshkruar me një agjenci sigurimesh (pa përmendur emrin, se ju e keni aty të shkruar) një marrëveshje për një pagesë mujore, që do të bëhet nga biznesi për punonjësit e tyre, për sigurimin në rast dëmtimesh në punë, t'u sigurojmë ulje të çmimeve të vizitave periodike dhe të nevojshme që kanë këta punonjës.

Ajo që kërkojmë nga ju, që është në dorën tuaj, duke qenë se ky sektor ka një mungesë të theksuar të krahut të punës, përtej të gjithave çfarë u thanë, (në shoqërinë shqiptare rezultojnë mbi 97 mijë të papunë), duam që me ndihmën tuaj këta njerëz të riintegrohen në vendin e punës, si dhe të kenë një pagë më të lartë sesa paga minimale dhe asistencë sociale që marrin nga shteti (po dal nga tema, por gjithmonë flas për sigurinë në punë dhe vendin e punës).

Petrit Vasili – Faleminderit, që mu drejtuat!

Në planin personal, miku im, nuk i je drejtuar njeriut të përshtatshëm! Ju e dini që për një sektor të caktuar me shumë punonjës, siç është fasoneria, ne i kemi propozuar qeverisë 2-3 paketa me radhë në atë kohë, madje kemi hyrë në konflikt me qeverinë dhe me partnerët që ishim koalicion vetëm për këtë çështje.

Kështu që, dua të them se në planin personal më keni me vete (si asnjëherë tjetër, për gati 6 muaj rresht ne kemi vizituar pothuaj të gjitha fasoneritë) pasi kam bërë më shumë se ç'më takonte edhe për mandatin politik, edhe për raportin politik që kam pasur. Këtë ndjeshmëri inshallah ta kenë të gjithë kolegët e mi, po e patën do të keni një aleancë shumë të mirë në parlament!

Grida Duma – Ne vetëm i kemi cekur problemet, pa asnjë diskutim.

Dua t'u them përfaqësuesve të biznesit që, në një mënyrë apo një tjetër, ndërgjegjësimi juaj për hapësirën tuaj është një gjë, por është tjetër gjë të ndërtohet një sistem kombëtar të efektshëm midis kontrollit dhe cilësisë së parandalimit.

Ashtu siç e thashë në fillim, patjetër që biznesi nuk jeton në një frymë shumë paqësore në vende me ekonomi transitore të ekonomisë së tregut, por, nga ana tjetër, mos u ndjeni sikur kritikant janë për ju. Ato, së pari, nisin me sistemin, të cilin e ndërton ligjvënësi dhe detyra e parë që na

takon është të kryejmë një takim të radhës me të gjitha institucionet që kryqëzohen sa i përket sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.

Për mua personalisht është e papranueshme që së paku dy institucionet që inspektojnë, të mos kryqëzojnë të dhënat, së pari.

Së dyti, është e papranueshme që një traditë e mirë historike që ka qenë, le të themi patologjitet që vijnë nga vendi i punës profesionale, të zhduket si sistem. Nga ana tjetër, ne e dimë shumë mirë që mjeku në vendin e punës është thujse një procedurë burokratike dhe jo konkrete, ky është realiteti. Në këtë vend ka ndodhur që emisionet mediatike investigative të kenë nxjerrë realitetin shumë më tepër se dokumentacionet formale burokratike dhe ky është realiteti shqiptar.

Këtu nuk jemi për të bërë gjuetinë e shtrigave të askujt, por domosdoshmërisht jemi këtu që në logjikën time, dhe besoj e kam edhe mbështetjen e kolegëve, të mos e lëmë me kaq këtë çështje. Studimi që na ka ardhur nga Mirela, ka ardhur dje dhe është një kohë e pamjaftueshme për ta shqyrtuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa diskutim, ajo që tha edhe profesori, ku mjekët, infermierët dhe stafi shëndetësor kanë një dhunë të nivelit të tretë, nuk e patëm kohën dhe nuk e kemi, që të diskutojmë që nga platformat e denoncimit të mjekëve, tek integriteti i mjekut dhe gjithçka tjetër, kjo është një tjetër histori e respektimit dhe sigurisë në punë, pra kemi shumë për të koordinuar.

Ne do të diskutojmë edhe me kolegët, pasi ju të ikni, për një strategji të vijimit të kësaj çështjeje. Efektin postligj e kemi të thjeshtë ta diskutojmë, ndërkohë që koordinimi për rithemelimin e një sistemi më eficient është, sigurisht, një punë që kërkon shumë më tepër se sa një tryezë: kërkon ekspertizë, kërkon kryqëzim të dhënash dhe një propozim për vendimmarrje .qofshin këto amendime apo ndërhyrje në ligj, për të cilat me sa duket edhe mund të shkojmë drejt saj.

Mbetet e rëndësishme çështja e përcaktimit të mjekut të punës, specialitetit të tij. Unë shpresoj që deri në takimin e radhës kjo organigrama me 160 të jetë e mbyllur dhe të mos kemi vakanca kur kemi kaq shumë mungesa.

Ne do t'ju njoftojmë për takimin e radhës, si dhe do t'ju njoftojmë se si do të vijojmë për ndërhyrjet e mundshme dhe për kryqëzimin e situatave.

Mirela Pitushi – Faleminderit, kryetare!

E dëgjova me vëmendje të gjithë hulumtimin që u bë sa u përket 3 metodologjive dhe 3 projekteve, ku iu mëshua pjesës së shëndetësisë më tepër. Pak a shumë e kam të prekur, pasi e njoh edhe pjesën se si funksionon mjeku i familjes, që është i punësuar pranë një subjekti. Dua të shtoj diçka, që mjeku i familjes aty është në mbarëvajtje të procesit të punës, jo anketues. Nëse do të mbyllej formati dhe gjithë kjo pjesë e bashkëbisedimit, jam e mendimit që këtu duhet të ishte i ftuar përfaqësuesi i Inspektoratit të Shëndetësisë, i cili mund të na jepte një panoramë më të thellë të procedurës, sepse mjeku i familjes, në dijeninë time, është për mbarëvajtjen e procesit të punës në fasoneri ose manufakturë dhe nuk është për të nxjerrë statistika, që të na i sjellë në komision sa i përket anës shëndetësore.

Për zonjën Mirela, kisha një pyetje. Paska ikur zonja. Ajo tha që 13% e grave nuk kanë marrë lejen e lindjes. Nga se ka ardhur kjo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në Kodin e Punës nuk ka pozicion pune për marrjen e lejes së lindjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S'mund të ketë presion për këtë, pasi në Kodin e Punës është mirëpërcaktuar, ke edhe një kontratë...

(Drejtimin e komisionit e merr zonja Spahiu.)

Klodiana Spahiu – Përderisa zonja u largua, ne do ta lexojmë dhe do të rikthehemi sërish. Keni pyetje të tjera, Mirela?

Florian Zekja – Nuk e gëzon lejen e lindjes vetëm në qoftë se punëdhënësi nuk e ka deklaruar punëtorin që është shtatzënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka lidhje me Inspektoratin e Punës dhe jo me këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shifrat nuk janë të vërteta.

Irida Qosja - Këto janë studime që prezantohen, ka një target të caktuar, ndërkohë të dhënat e Inspektoratit janë për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetin këtu.

Klodiana Spahiu – Zonja Qosja, kisha një pyetje, nëse mundeni.

Ne e kaluam konventën dhe aty na është prezantuar edhe nga ministria që janë bërë një sërë ndryshimesh në një paketë ligjesh. Pa dyshim, ju do të jeni të përfshirë në këtë punë. Keni filluar nga puna për këto ndryshime?

Irida Qosja - Në dijeninë time, ne kemi përfaqësuesit tanë, pikërisht përgjegjës in e sektorit juridik, pjesë të grupit të punës të ngritur me urdhrin e ministres për përmirësimin e paketës me kuadrin ligjor, por që është një proces që udhëhiqet nga drejtoria e politikave në ministri.

Petrit Vasili - Do të doja të bëja një sqarim për zonjën Pitushi, për të qenë në rregull me referimet.

Zonja Pitushi, nuk është mjeku, siç e thatë, që administron punën. Mjeku i ndërmarrjes ka një VKM të vitit 2018...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ta lexoj nga fillimi deri në fund detyrat nuk janë ato që thoni ju. Nuk bëhet fjalë për statistikat. Shiko, si është puna, ndoshta flasim në gjuhë të ndryshme, se ju ndoshta nuk e njihni këtë pjesë. Anketa e sëmundjeve profesionale nuk ka të bëjë me statistikat, që do të thotë se nga pikëpamja individuale cilët janë elementet që dyshojnë për një sëmundje profesionale, është pjesë e detyrave që bën ky. Të gjitha bashkë nuk i përpunon ky, ata që vijnë dhe i marrin këto të dhëna, mund t'i përpunojnë nga ana statistikore. Pra nuk është pretendimi që të bëjmë statistikë. Ky nuk administron, ky bën hulumtimin e sëmundjeve profesionale.

Mjeku i familjes nuk është këtu, por ky, në rast se ka probleme, ia referon mjekut të familjes për gjëra që i përballon mjeku i familjes, për gjëra të tjera i referon në një vend tjetër. Po ta shohësh nga fillimi në fund, çfarë bëhet në realitet është tjetër gjë, por çfarë kërkon ligji dhe vendimi i qeverisë përkatëse i vitit 2018, është tjetër gjë. Ndaj po themi se ai që duhet ta mbulojë atë shërbim, duhet të përmbushë ato kërkesa që thotë ky vendim. Shqetësimi është që në raport me atë se çfarë bëhet dhe është kaq formale, nuk bëhet as 1/50. Në kurriz të kujt bie kjo? Bie në kurriz të njerëzve, që ka përsipër të ndjekë. Kaq e thjeshtë është.

Klodiana Spahiu – Faleminderit, zoti Vasili!

Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera..

Po, urdhëroni!

Irida Qosja – Thjesht kisha një koment të fundit. Në lidhje me studimin që prezantuar si Qendra për të Drejtat në Punë, studimi është thjesht një studim kombëtar, që ka pasur një kampionim të caktuar, që nuk janë të dhënat e INSTAT-it dhe nuk mund të bëhen kurrë, ama nxjerr probleme dhe çështje që janë të rëndësishme për të diskutuar, që qartësisht nevojitet edhe më shumë diskutim nga ç'u bë këtu. Kjo është një kërkesë jona si qendër, por edhe e aktorëve të tjerë, në qoftë se do të jetë e mundur për të bërë një diskutim të mëtejshëm lidhur me këtë çështje. Ka

nevojë të zgjerohemi dhe thellohemi për këto çështje që sapo i ngritëm, por edhe për rekomandimet që ngritëm bashkë me aktorët e tjerë, gjithashtu.

Kështu që, në qoftë se ka nevojë për bashkëpunim dhe më shumë përfshirje, nga ana jonë, si shoqëri civile, ne jemi gjithmonë të gatshëm për ta bërë këtë, por kemi nevojë edhe për më shumë bashkëpunim nga ana juaj, pra t'i jepet sa më shumë mundësia shoqërisë civile, si e tillë, të ngrejë zërin për çështje që janë shumë të rëndësishme në lidhje me punën.

Klodiana Spahiu – Faleminderit, për propozimin!

Në këtë komision, në fakt, ka pasur gjithmonë një frymë bashkëpunuese, ashtu siç e patë, sa herë ka pasur kërkesa nga shoqëria civile, ato janë reflektuar menjëherë nga përgjigja e komisionit. Fakti i kërkesës suaj, që është realizuar brenda pak ditësh, tregon që komisionin e keni pasur gjithmonë në gatishmëri.

Ju falënderojmë!

Në qoftë se nuk ka pyetje dhe diskutime të tjera, mendoj ta mbyllim këtë seancë dëgjimore, duke mos qenë e fundit, pa dyshim, ashtu siç edhe ju e propozuat. Materialin na e keni dërguar, do ta lexojmë me vëmendje, edhe atë të zonjës Arqimandriti, dhe më pas ne do të vendosim në kalendarin e punimeve të komisionit edhe ditën për takimin e radhës.

Të nderuar kolegë, bëjmë 5 minuta pushim dhe vazhdojmë me mbledhjen e radhës.